**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**

**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

**KRYETARI I KOMUNËS**

14-030/01-101454/18, më 27. 04. 2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr këtë

**U R D H Ë R E S Ë**

I. N D A L O H E T qarkullimi i të gjitha automjeteve, përveç autobusëve të NPL "Trafiku Urban", linja 4, automjeteve të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, të EULEX-it, të ndërmarrjes "Hortikultura", të KRM "Pastrimi", të Drejtorisë së e Inspeksionit dhe automjeteve emergjente, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Maji, më 1 maj 2018, në drejtim të parkut "Gërmia", ndërsa linja 5 e transportit publik do të punojë sipas itinerarit dhe orarit të rregullt deri në Sofali.

II. Pika përfundimtare për lëvizjen e automjeteve, përveç banorëve të lagjeve: "Normale", "Sofalia", "Tauk-Bahçe" dhe restoranteve - vilat: "Gërmia", "Freskia" dhe "Lira", do të jetë:

- Kryqëzimi i rrugëve "1 Tetori" – "Nazim Gafurri" dhe "Ymer Lutfi Paqarizi";
- Kryqëzimi i rrugëve "Nazim Gafurri" - "Xhavit Ahmeti" dhe "Dr. Lec Gradica";
- Kryqëzimi i rrugëve "Dr. Shpëtim Robaj" me atë të Sofalisë, në drejtim të pishinës dhe parkut "Gërmia".

III. Transporti publik i qytetarëve për në parkun "Gërmia" deri te pishina, do të bëhet ekskluzivisht me autobusë të NPL "Trafiku Urban", linja 4.

IV. Inspektorët përgjegjës të Drejtorisë së Inspeksionit, për datën e cekur në pikën **I** të urdhëresës, do të:

- parandalojnë shërbyesit e paautorizuar që të bëjnë shitjen – shërbimin ndaj qytetarëve;
- organizojnë kujdestari, me qëllim të ruajtjes së ambientit (përdorimin e zjarreve për destinime të ndryshme), si dhe hedhjen e mbeturinave në vende të caktuara.

V. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.

VI. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e marrjes së saj.

U DORËZOHET:

- NPK "Trafiku Urban", linjat 4 dhe 5;
- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti